



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 11191 Prot.

26

Tiranë, më 18.10 2020

V E N D I M

Nr. 38 Datë 07.10. 2020



Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 07.10.2020, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Marenglen Kasmi	Anëtar
Z. Simon Mirakaj	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT:

Për miratimin e Udhëzuesit “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish Sigurimit të Shtetit”.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullorja “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, Ligji nr. 8487, datë 11.12.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi projekt aktin, “Mbi Politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish Sigurimit të Shtetit”, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj,

V Ë R E N:



Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si institucion i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish- Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, si dhe Rregullorja “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, e cila rregullon dhe normon veprimtarinë e Autoritetit sipas procedurave përkatëse.

Gjithashtu në bazën ligjore me të cilën Autoriteti udhëhiqet në punën e vet është edhe Urdhëri nr. 6, datë 16.01.2020 mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe personave privatë për informimin pranë Autoritetit.

Ky urdhër ka të përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat e hallkat e institucionit që nga Kryetarja, Anëtarë, Sekretar i Përgjithshëm dhe Sekretariati Teknik, nëpër të cilat kalon trajtimi i kërkesave individuale dhe institucionale.

Pas eksperiencës tre vjeçare të autoritetit, duke pasur parasysh bazën ligjore nga të cilat Autoriteti udhëhiqet në punën e vet, ka dalë nevoja për hartimin e një udhëzuesi të ri mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish Sigurimit të Shtetit”, duke qenë se këto kërkesa janë shumë specifike dhe kërkojnë procedura të ndryshme nga ato që janë parashikuar në Urdhrin nr. 6, datë 16.01.2020, të sipërpërmendur.

Ky udhëzues do të zbatohet nga Sekretariati Teknik i Autoritetit, në lidhje me trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, që kanë aplikuar pranë Autoritetit.

Udhëzuesi parashikon të gjitha hallkat, veprimet dhe hapat që do të ndiqen nga ana e Sekretariati Teknik, komform bazës ligjore të sipërpërmendur, duke e bërë veprimtarinë e Autoritetit transparente dhe duke ndikuar në integritetin e Institucionit.

Duke përcaktuar veprime proceduralë, gjë e cila nuk parashikohet në ligjin organik të Autoritetit, ligji nr.45/2015, i ndryshuar, nëpërmjet këtij udhëzuesi do të kemi mundësi të standardizojmë procedurat që do ndiqen për trajtimin e kërkesave për zbardhje bashkëpunëtorësh, në funksion të kryerjes së detyrës që na ka caktuar ligji me korrektësi.

Në përfundim, sa më sipër, draft Udhëzuesi “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish Sigurimit të Shtetit”, që ka të bëjë me procedurat për trajtimin e kërkesave për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, të paraqitura nga subjektet e parashikuara në ligjin 45/2015, pranë Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, duhet të miratohet dhe të vihet në zbatim sipas parashikimeve ligjore.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në ligjin 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, miratuar me Vendim nr.21, datë 09.05.2017 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

VENDOSI

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARJA

Gentiana Sula
Gentiana Sula

ANËTAR

Altin Hoxha
Altin Hoxha

ANËTAR

Dr. Marenglen Kasmi
Dr. Marenglen Kasmi

ANËTAR

Simon Mirakaj
Simon Mirakaj